| | |
|---|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti Ekonomik |
| Titulli i lëndës: | Politikë tregtare e avansuar |
| Niveli: | Master |
| Statusi lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | 2 |
| Numri i orëve në javë: | 3 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 6 |
| Mësimëdhënësi i lëndës: | Prof. asoc. Petrit Gashi |
| Detajet kontaktuese: | Fakulteti Ekonomik, UP, zyrja 84, kati 7<br>E-mail: petrit.gashi@uni-pr.edu<br>Konsultimet: 24/7 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Përshkrimi i lëndës | Lënda Ekonomiks i Tregtisë Ndërkombëtare 2 është e ndarë në dy pjesë kryesore, ku e para mbulon teoritë e tregtisë ndërkombëtare, ndërsa e dyta mbulon temat e ndërlidhura me politikën tregtare. Në kontekst të teorive të tregtisë ndërkombëtare, diskutimi fillon me teorinë standarde të tregtisë, pastaj vazhdon me trajtimin e modeleve të avancuara të përparësive krahasuese, me theks të veçantë në modelin Heckscher-Ohlin, dhe përfundon me efektet e ekonomive të shkallës në tregtinë e jashtme. Në kontekst të politikës tregtare, prezantohen mekanizmat standard të politikës tregtare, si instrumentet tarifore dhe jo-tarifore, si dhe marrëveshjet tregtare. Në kontekst të kësaj të fundit, lënda koncentrohet në qeverisjen globale të tregtisë. Më pas, lënda koncentrohet në ndërlidhjen e politikës tregtare me politikat e tjera makroekonomike, veçanërisht politikën industriale. Diskutimi përmbyllet me metodat hulumtuese në tregtinë e jashtme. | | |
| Qëllimet e lëndës: | Qëllimi primar i lëndës është t'u ndihmojë studentëve të krijojnë një qasje analitike të studimit të çështjeve bashkëkohëre të ekonomisë ndërkombëtare duke njohur modelet e avancuara teorike të tregtisë ndërkombëtare dhe të politikës tregtare. Për më tepër, lënda synon t'u jap njohuritë e mjaftueshme studentëve që të jenë në gjendje të gjykojnë dhe studiojnë empirikisht zhvillimet ekonomike dhe tregtare globale. | | |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | Pas përfundimit të mësimit, studentët pritet të jenë në gjendje të:<br>1. Njohin qartë modelet e avancuara të tregtisë ndërkombëtare;<br>2. Njohin qartë mekanizmat e politikës tregtare, dhe të jenë në gjendje t'i shohin këta mekanizma nga perspektiva e zhvillimit ekonomik;<br>3. Të ndërlidhin politikën tregtare me politikat e tjera makroekonomike, si dhe zhvillimin ekonomik;<br>4. Të kenë njohuritë bazike mbi metodat kryesore të hulumtimit të këmbimeve tregtare në mes të vendeve. | | |
| Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithësej |
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 10 | 10 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 3 | 5 | 15 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | 3 | 3 | 9 |
| Totali | 11 | 48 | 94 |
| Metodologjia e mësimëdhënies: | Çdo javë mbahen nga 2 orë ligjërata. Në ligjerata studentët përfshihen në debate rreth çështjeve të ndryshme në kontekst të tregtisë ndërkombëtare. Studentët inkurajohen që të përcjellin rrjedhat ekonomike në tregtinë ndërkombëtare, si në vend dhe jashtë. | | |

**Metodat e vlerësimit**

Studentët pritet të marrin pjesë në të gjitha ligjëratat. Studentëve gjithashtu do t'u kërkohet të shkruajnë një punim të shkurtër dhe të bëjnë një test në fund të semestrit. Testi do të përmbajë një kombinim të pyetjeve me alternativa dhe pyetjeve të llojit ese. Krahas suksesit që studenti tregon në test dhe punim, nota përfundimtare merr parasysh se sa aktiv ishte studenti në leksione, duke përfshirë pjesëmarrjen, detyrat e shtëpisë, punën e pavarur, etj.

Më poshtë është dhënë struktura e vlerësimit gjatë procesit mësimorë (semestrit), dhe e vlerësimit pas procesit mësimorë:

| Aktivitetet | Notimi gjatë procesit mësimor (ligjeratave/ semestrit) | Notimi pas procesit mësimor (ligjeratave/semestrit) |
|---|---|---|
| Provimi | / | 75%[1)] |
| Testi | 55% | Të gjitha aktivitetet gjatë ligjeratave iu sigurojnë shtesë maksimum 25% |
| Punimi | 25% | |
| Pjesëmarrja | 10% | |
| Detyrat | 10% | |
| Gjithsej | 100% | 100% |

*Vërejtje:*

1) Studentët të cilët i nënshtrohen provimit dhe nuk realizojnë asnjë nga aktivitetet gjatë semestrit notën maksimale që mund të marrin është nota 8.

Përqindjet korespondojnë me notat në vijim:

| | | |
|---|---|---|
| Nota 10 | ⇨ | Mbi 90% |
| Nota 9 | ⇨ | 80 – 89% |
| Nota 8 | ⇨ | 70 – 79% |
| Nota 7 | ⇨ | 60 – 69% |
| Nota 6 | ⇨ | 50 – 59% |
| Nota 5 | ⇨ | Nën 50% |

Punimi nuk duhet të kaloj shtatë (7) faqe *double-spaced* (përfshirë tabelat, fusnotat, anekset) dhe duhet të dorëzohet në takimin përfundimtar (d.m.th. orën e fundit) të semestrit. Tema do të jetë si më poshtë:

***Identifikoni një problem me të cilin përballet sot tregtia ndërkombëtare dhe jepni disa mendime rreth burimit të këtij problemi dhe zgjidhjes së mundshme***

Në këtë punim, nga ju pritet të përcaktoheni për analizën e ndonjë problemi bashkëkohore lidhur me tregtinë ndërkombëtare dhe të vlerësoni zgjidhjet alternative të politikave, duke marrë parasysh dimensionet ekonomike, politike, dhe sociale të çështjes. Zgjedhja e temës specifike varet nga ju. Fokusi i punimit duhet të jetë në atë se cilat alternativa në politikë-bërje

| | |
|---|---|
| | janë krahasimisht më efektive dhe fizibile në kontekst të problemit të cilin e keni zgjedhur për të studijuar. Në mënyrë specifike, duhet adresuar çështjet në vijim:<br>1) cili është problemi, cila është origjina e tij dhe pse është i rëndësishëm?<br>2) cilat zgjidhje mund të propozohen dhe cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të tyre?<br>3) a është një zgjidhje e vetme në politikë-bërje qartësisht superiore për të zgjidhur problemin, apo problemi kërkon një kombinim zgjidhjesh?<br>Qëllimi i punimit është analiza krahasuese, e jo vetëm të përshkruhet problemi. Kjo do të thotë që ju duhet të përpiqeni të bëni tre gjëra:<br>a) identifikoni çështjet kryesore të lidhura me problemin që zgjedhni të diskutoni;<br>b) identifikoni dhe vlerësoni zgjidhjet e mundshme alternative; dhe<br>c) argumentoni me fakte zgjedhjen tuaj të preferuar në politikë-bërje.<br>Kur të bëni zgjedhjen tuaj specificke se cili/at hap/a duhet ndërmarrë, nuk mjafton thjesht të shprehni mendimin tuaj, ju gjithashtu duhet të thoni, për aq sa është e mundur, se përse zgjedhja që keni bërë është më e mirë se çdo zgjedhje tjetër alternative. Me fjalë të tjera, ju duhet të krahasoni mundësitë alternative, duke peshuar dhe vlerësuar pikat e forta dhe të dobëta të secilës alternativë sa më mirë që mundeni. |
| Plani i mësimit dhe literatura | |
| | Tema 1: Teoritë standarde të tregtisë ndërkombëtare<br>Tema 2: Këmbimet tregtare dhe burimet: Teoria Heckscher-Ohlin<br>Tema 3: Konkurenca monopolistike dhe tregtia e jashtme<br>Tema 5: Ekomomitë eksterne të shkallës dhe vendndodhja e prodhimit global<br>Literatura: Çfarëdo libri i Ekonomiksit Ndërkombëtar. Ju mund t'i shfrytëzoni cilëndo nga librat në vijim:<br>▪ Krugman, P.R. and Obstfeld, M. (2012), *International Economics: Theory and Policy*, edicioni i nëntë, New York: Addison-Wesley;<br>▪ Salvatore, D. (2007), *International Economics*, botimi i nëntë, New York: Wiley;<br>▪ Feenstra, R. C. and Taylor, A. M. (2008), *International Economics*, New York: Worth;<br>▪ Appleyard, D. and Field, A. (2005), *International Economics*, botimi i nëntë, McGraw Hill.<br>Tema 5: Politika tregtare dhe instrumentet e saj<br>Literatura:<br>▪ Krugman, P.R. and Obstfeld, M. (2012), *International Economics: Theory and Policy*, edicioni i nëntë, New York: Addison-Wesley (kapitulli 9);<br>▪ Deardorff, A. dhe Stern, R. (1997), Measurment of Non-tariff Barriers. Economics Department Working Papers, University of Michigan. |

| | |
|---|---|
| | Tema 5: Politika tregtare nga prizmi i politikës ekonomike ;<br>Literatura:<br>▪ Balaam, D. dhe Dillman, B. (2014). *Introduction to International policical Economy*. Edicioni i 6. Boston: Pearson. (kapitij të zgjedhur)<br>▪ Oatley, T. (2019). *International policical Economy*, Edicioni i 6. New York: Routledge (kapituj të zgjedhur)<br>▪ Krugman, P.R. dhe Obstfeld, M. (2012), *International Economics: Theory and Policy*, edicioni i nëntë, New York: Addison-Wesley (kapitulli 10);<br>Tema 6: Politika industriale dhe përparësitë krahasuese dinamike<br>Literatura: Për aspektet bazike shih:<br>▪ Todaro, M. dhe Smith, S. (2012), *Economic Development*, Edicioni i 11. Boston: Addison-Wesley (kapitulli 12; faqe: 564 - 637).<br>▪ Rodrik, D. (2007), *One Economics, Many Recipes*, New Jersey: Princeton University Press (kapitulli 4, faqe: 99 - 153);<br>▪ Gashi, P. Hisarciklilar, M. dhe Pugh, G. (2016). Kosovo – EU Trade Relations: A Dynamic Panel Poisson Approach. Applied Economics.<br>▪ Kowalski, P. (2011). Comparative Advantage and Trade Performance: Policy Implications. OECD Trade Policy Papers, No. 121, OECD Publishing. http://dx.doi.org/10.1787/5kg3vwb8g0hl-en<br>Tema 7: Qeverisja globale e tregtisë dhe masat kontigjente<br>Literatura: E njëjta literaturë si në kuadër të temës 1. Si dhe:<br>▪ WTO () *A Handbook on Accession to the WTO*. Cambridge: Cambridge University Press. (http://assets.cambridge.org/97805214/25940/frontmatter/9780521425940_frontmatter.pdf).<br>▪ WTO (2009), *World Trade Report 2009: Trade Policy Commitments and Contingency Measures*, Gjenevë: WTO (pjesa C, faqe: 47 – 117).<br>Tema 8: Hulumtimet empirike në tregtinë e ndërkombëtare<br>Literatura:<br>▪ Shepherd, B. (2013). The Gravity Model of International Trade: A User Guide." United Nations ESCAP. (http://www.unescap.org/tid/publication/tipub2645.pdf).<br>▪ WTO (2012), *A Practical Guide to Trade Policy Analysis*. Geneva: World Trade Organization (https://www.wto.org/english/res_e/publications_e/wto_unctad12_e.pdf) |
| Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: | |
| Studentët duhet të marrin pjesë në ligjërata dhe të jenë aktiv në diskutime. Nota përfundimtare do të varet në masë të madhe nga pjesëmarrja aktive në mësim. | |